



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 24.04.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, Slobodan Petroviq, Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Igor Simiq, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Jasmina Zhivkoviq, Sasha Milosavljeviq dhe Zoran Mojsiloviq.

I ftuar: Ekrem Mustafa, ministër i Ministrisë për Punë të Brendshme dhe Rashit Qalaj, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Pjesëmarrës tjerë janë: Fatos Rushiti, këshilltar politik; zyrtarë të lartë, Afrim Ahmeti dhe Dejan Jankoviq.

Pjesëmarrës tjerë: Sanije Berisha- OSBE; Ilir Hoxha KDI; Albina Haliti, “RTV Dukagjini”; Florian Sylja dhe Nexhmie Hyseni, “Ekonomia Online”; Burbuqe Ibishi, “Kosova Press”; Mejreme Tahiraj, “Radio Kosova”, Emijeta Vllahu, Kallxo.com; Ivan Milkoviq, gracanicaonline.info, Celal Iliaz, drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun dhe praktikant, Arbër Thaçi.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Raportimi i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Ekrem Mustafa, lidhur me gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe incidentet që kanë motive ndëretnike;**
3. **Formimi i grupit të punës lidhur me mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësitë të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim;**
4. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetari, duke hapur takimin, e falënderoi ministrin, drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe të pranishmit tjerë për prezencën e tyre dhe fillimisht, kërkoi të shqyrtohet pika e tretë e rendit të ditës, pastaj për hir të respektimit të kohës do të vazhdohet me raportimin e ministrit.

Rendi i ditës u miratua me këtë propozim ndryshim.

2. Formimi i grupit të punës lidhur me mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

Zëvendëskryetari, kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen, të jenë pjesë e Grupit Punues, lidhur me mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Pas konsultimeve të anëtarëve të Komisionit, u mor qëndrim që të formohet Grupi Punues me këtë përbërje: kryesuese- Duda Balje, anëtarë tjerë: Veton Berisha, Albert Kinolli, Rasim Selmanaj dhe Slobodan Petroviq.

Zëvendëskryetari, pasi komisioni nuk është në përbërje të plotë, kërkoi nga administrata për mbështetje të komisionit, të realizojë kontaktet me anëtarë tjerë, me qëllim që të paraqesin vullnetin e tyre, të jenë pjesë e këtij grupi punues.

Pas konsultimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në këtë përbërje: kryesues- Duda Balje, anëtarë tjerë: Veton Berisha, Albert Kinolli, Rasim Selmanaj dhe Slobodan Petroviq.

3. Raportimi i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Ekrem Mustafa, lidhur me gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe incidentet që kanë motive ndëretnike

Zëvendëskryetari, Xhelal Sveçla, fillimisht e falënderoi ministrin për dërgimin e materialit të kërkuar nga ana e komisionit, lidhur me rastet me motive ndëretnike.

Duke pasur parasysh zhvillimet të cilat janë të ndërlydhura me ministrinë të cilën ju e udhëhoqni, ju kemi ftuar të raportoni për situatën e sigurisë në Kosovë dhe rastet me motive ndëretnike, në mënyrë që të shohim se cilat kanë qenë të arriturat dhe ngecjet në këtë drejtim.

Ekrem Mustafa, ministër i Punëve të Brendshme, tha se jam i nderuar që sot raportoj para jush, për të arriturat dhe gjendjen e sigurisë në Kosovë. Ai tha se ministria është e përkushtuar në të gjitha segmentet, sidomos në ruajtjen e rendit juridik dhe zbatimit të ligjit, në veçanti në funksion të sigurisë së të gjitha komunitetet jo shumicë. Ministria, është e angazhuar që komunitetet të trajtohen në mënyrë të barabartë, kur është nevoja, të diskriminohen në mënyrë pozitive. Për të pasur siguri të plotë, është i nevojshëm edhe përfaqësimi i strukturave etnike.

Z. Mustafa ofroi disa statistika rreth gjendjes së përgjithshme të sigurisë në vend. Sipas raportit, janë përcaktuar rreth 1.650 pikë negative në komunikacion. Ndalimi i mjeteve me veprim motorik, janë 6.485 sosh. Krahasuar me raportin e 3 mujorit të parë të vitit 2018 dhe tre mujorit të parë të vitit 2019, është zvogëluar numri i aksidenteve në trafik. Për fat të keq është rritur numri i rasteve me fatalitet. Si vepër penale, janë ndaluar 107 persona për grabitje të armatosur në vitin 2018, ndërsa, në periudhën janar-shkurt 2019, janë arrestuar 23 persona.

Në vitin 2018, janë regjistruar si vepër penale 87 raste të rëndë, ku përfshihen vjedhje të rënda, zjarr vënie, shkruaje të grafikeve, dëmtim të pasurisë, etj.

Janë regjistruara rastet për dëmtime të trashëgimisë fetare myslimane 56, ortodokse 1 rast, katolike 7 raste, dhe bashkësive të tjera fetare 3 raste. Në periudhën janar-mars 2019, kanë ndodhur 25 raste të dëmtimit të trashëgimive fetare, prej të cilave 15 raste ndaj objekteve të trashëgimisë myslimane, 8 raste të objekteve të trashëgimisë ortodokse, dhe 2 raste të objekteve të trashëgimisë fetare të tjera.

Në periudhën janar-dhjetor 2018, janë raportuar 10 raste, të incidenteve ndëretnike. Për periudhën janar 2019, janë raportuar 4 raste. Me këto statistika, ministri e mbyll raportin për gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe falënderon komisionin për bashkëpunimin.

Zëvendëskryetari, fjalën për diskutim ia dha drejtorit të Policisë së Kosovës, z. Rashit Qalaj, që të shtjellojë çështjen rreth sigurisë në Kosovë.

Drejtori i Policisë së Kosovës, z. Rashit Qalaj tha se sipas raporteve të Policisë, situata është mjaft e sigurt dhe e qetë në vend, nga se ka rastet e krimit janë në rënie çdo ditë, përpos rasteve në fushën e aksidenteve rrugore dhe me fatalitet.

Në tremujorin e parë të vitit 2019, janë hapur gjithsejtë 9.140 raste, prej tyre janë klasifikuar 6.855 raste për vepra penale, 2.285 raste si vepra për kundërvajtje, si dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e vitit të kaluar, është zvogëluar numri i rasteve në 7, 45%, ndërsa për vepra penale në 4, 19%. Për të njëjtën periudhë, numri i vrasjeve ka rënë prej 10 në 7, dhe sipas tij, të gjitha këto raste janë zbuluar.

Numri i vjedhjeve ka shënuar rënie prej 14, 39%, siç janë rastet e vjedhjeve të rënda 19, 47%, i grabitjeve 8, 95%, i grabitjeve të armatosura 13.47%. Ndërsa, numri i aksidenteve fatale ka shënuar rritje prej 42, 55%, të cilën çështje e konsideron mjaft shqetësuese.

Për periudhën janar-dhjetor 2018, janë raportuar 10 raste, prej të cilave 9 prej tyre janë zbuluar, ndërsa 1 rast është nën hetime. Në përgjithësi, 3 raste janë të komunitetit serb, 3 raste të komunitetit shqiptar dhe rastet tjera vijnë nga komunitetet tjera. Rastet e mundshme ndëretnike janë: 1 rast nën hetime, dhe 2 raste janë mbyllur. Si fokus i veçantë i policisë, është parandalimi i rasteve të krimeve ndëretnike, paraprakisht arrestimi i personave që janë subjekt i këtyre veprave.

Rastet e mundshme ndëretnike, janë hapur në baze të kodit penal të vjetër, me nenet;147, 421,332 dhe 333.

Për periudhën janar-mars 2019 gjithsejtë janë regjistruar 4 raste me motive ndëretnike, prej të cilave 1 rast është i komunitetit egjiptian, ndërsa 3 raste të komuniteti serb, dhe se 1 rast është dërguar në prokurori. Krahasuar me vitet 2018/2019, kemi rritje të rasteve ndëretnike prej 2 në 4 raste. Vetëm 25% të rasteve me incidente ndëretnike, rrjedhin nga dëmtimet e trashëgimisë kulturore, ndërsa rastet tjera për shkaqe personale. Në fund tha se ka keqinterpretime për numrin e rasteve, dhe sipas tij, qëndrojnë vetëm statistikat të cilat ai i prezantoi.

Sipas z. Qalaj, për këtë vit, një ndër sfidat më të mëdha do të jetë lufta kundër narkotikëve dhe trafikimi me qenien njerëzore. Që nga muaji shtator i vitit 2018 e deri në muajin mars 2019, janë shkatërruar 15 grupe kriminale, janë konfiskuar 122 kg heroinë, 2,84 kg kokainë, 881,66 kg marruan, 10,135 kg farë kanabisi dhe 0,48 kg hashash. Ai potencoi se këto statistika janë mjaft të suksesshme dhe inkurajuese, në krahasim me periudhën e vitit të kaluar.

Veton Berisha, falënderoi ministrin z. Mustafa dhe drejtorin e Policisë, z. Qalaj, për raportim të mirëfilltë dhe korrektësinë e tyre, para komisionit.

Ai tha se ka tendenca të dilet në opinion se komunitetet nuk kanë siguri, ju cenohen të drejtat e tyre, ka elemente të vrasjeve. Por, duhet të jemi real dhe të pranojmë faktin, se gjendja e sigurisë në Kosovë, është relativisht e mirë.

Ngriti si shqetësim, incidentin i cili ka ndodhur në Pejë, më 16.9 2018, me ç ‘rast është vrarë në rrethana ende të panjohura Kenan Sadriaj, person i cili i ka takuar komunitetit egjiptian, ndërsa rasti ende ka mbetur i pazbuluar. Sipas informatave që ka, si person dhe si familje nuk kishin pasur ndonjë mosmarrëveshje me ndokënd. Kërkoj nga ministri dhe drejtori i Policisë së Kosovës, të punohet më shumë në zbardhjen e rastit, në fjalë. Në këtë aspekt, kërkoj të dërgohet raporti me shkrim, për këtë çështje.

Diskutoi edhe për një rast tjetër, ku bëhet fjalë për burgosjen e një personi të dyshuar të përkatësisë etnike, dhe kjo informatë ka dalë në komunikatë. Në këtë aspekt, ai nuk pajtohet që të publikohet përkatësia etnike, para se të shpallet një verdik final gjyqësor. Sipas tij, duhet pasur kujdes ndaj opinionit i cili është i prirë të nxisë urrejtje ndaj personave me përkatësi etnike, fakt ky i cili shkakton pakënaqësi te komuniteti egjiptian.

Në fund, konkretizoi trazirat që kanë ndodhur në vitin 2004, ka situatë të pa kontrolluar, mbi nxitjen e personave të pa identifikuar në rrjetet sociale, në media. Pra, janë dy situata, duhet bërë kujdes në trajtimin e rasteve, të mbrohet identiteti personal dhe të cilësohet përkatësia etnike.

Z. Qalaj, theksoi se nuk ka njohuri të detajuar lidhur me rastin e vrasjes së Kenan Sadriaj. Ai, zotohet se do të dërgojë raportin me shkrim.

Danush Ademi, shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me rastet e të dyshuarve, qoftë edhe në rastet e krimeve të luftës. Mori si shembull, rastin e një personi nga familja Sheholli në Podujevë, i cili është dënuar me shumë vite burgim, përkundër veprës penale të kryer. Sipas tij, nuk është mirë të identifikohet përkatësia etnike, sepse paraqitet frikë te qytetarët dhe prishet rendi publik.

Pikërisht, për çështjen të cila lidhen me siguri, si rekomandim i tij ishte që të vendosen kamerat e sigurisë në shkolla, si dhe në parqet e qytetit, hap të cilin e konsideron se do të ndikojë në ruajtjen e qetësisë së qytetarëve.

Gjithashtu, përmendi rastin në Ferizaj dhe në Pejë, ku janë dënuar dy fëmijë në moshë 6 -7 vjeçare, për nxitje të urrejtjes, përçarje dhe mos durim kombëtar. Pretendon, se ka selektim të dënimeve, kur bëhet fjalë për komunitetin ashkali, dhe konsideron se kjo çështje nuk duhet të përsëritet në të ardhmen.

Mufera Serbica Shinik, pasi e mori fjalën, shfrytëzoi rastin të adresojë shqetësimin e saj për temë tjetër e cila ndërlidhet me vizualitetin e një flete e cila nuk e kuptoj a është për shkollë, si librezë shëndetësore, apo pasaportë diplomatike. Për mua është mandati i katërt si deputete, ku për këtë periudhë kam pas tre pasaporta diplomatike, dhe se dukshmëria e koperinës së pasaportës diplomatike po praqet hezitim për policinë. Sipas saj, nuk dihet se kush e hap apo thënë kush e fiton tenderin, mirëpo, si pasojë po bëhen keqpërdorime. Ajo, luti ministrin që në të ardhmen të kenë kujdes për këtë çështje.

Zëvendëskryetari, parashtrij disa pyetje për z. Qalaj, së pari, kërkoi të informojë për gjendjen e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës, sa është numri i zbulimit të incidenteve, në këtë pjesë. Nën dy, a janë gjetur kryerësit e veprës në rastin e djegies së një ambulance te Kodra e Minatorëve në Mitrovicën Veriore. Nën tre, a ekziston një plan operativ për mbrojtjen e territorit të Kosovës?

Drejtori i Policisë së Kosovës, z. Qalaj sipas tij, gjendja e sigurisë në pjesën veriore të vendit, është më ndryshe dhe zbulimi i incidenteve në këtë pjesë është më i vogël në krahasim me zonat tjera të Kosovës. Konsideron se kjo është pasojë e tensioneve të grupeve të ndryshme kriminale, ndikimi në popullatë nga shteti i Serbisë, si dhe zgjedhjet lokale që priten të mbahen së shpejti. Mendon, se duhet të operojnë patrulla të përziera etnike, në funksion të stabilitetit, në veri. Ai, shtoi se zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit, ka ndikuar për situatën ekzistuese, në veri. Meqenëse kjo çështje është politike, krahas punës së Policisë së Kosovës, nevojitet edhe asistencë politike e institucioneve tjera.

Ndërkaq, u zotua se ekziston plani operativ, për mbrojtjen e gjithë territorit të Kosovës. Nga shtatori i këtij viti, do të rekrutohen kadetë të rinj, të cilët do të garantojnë prezencën policore çdo kund, sidomos në zonat e përziera me përfaqësues të komuniteteve. Në fund, e njoftoi komisionin se do të dërgoj raportin me shkrim, për rastet specifike.

z. Qalaj, konkretizoi se zbulimi i rasteve të sulmeve fizike, është më i madhe në krahasim me çdo veprë tjetër penale. E pranoi faktin se informimi publik nuk është i kënaqshëm, nga se në pjesën veriore, ka pasur mungesë të një zëdhënësi për media. Konfirmoi, se para një muaji është emëruar një zëdhënësi për media, dhe shpresojmë që së shpejti do të kemi rezultate të duhura.

Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, z. Dejan Janković, u ndërlidh me temën e gjendjes së përgjithshme të sigurisë në Kosovë, duke i ri konfirmuar fjalët e drejtorit. Ai shtoi, se Policia e Kosovës është e pranishme në tërë territorin e Kosovës. Mirëpo, ofrimi i sigurisë për qytetarët dhe zgjedhja e të gjitha problematikave, kërkon angazhim më të madh, në këtë drejtim.

Zëvendëskryetari, përsëri iu drejtua **z. Mustafa**, me kërkesë që të informohemi edhe për rastet e kontrabandës në veri dhe faktin e prezencës së mallrave serbe në biznese. Gjithashtu, për rrjedhat e taksës 100%, të vendosur ndaj Serbisë.

Ministri z. Mustafa, shprehu qëndrimin e tij, se kontrabanda ka ekzistuar edhe para vendosjes së taksës. Konsideron, se ka mallra të pa doganuara në vlerë prej 40 milionë euro, dhe policia e Kosovës është duke ndërmarrë masat e duhura, për parandalimin e tyre.

Drejtori z. Qalaj, sipas tij, në dy muajt e fundit, janë konfiskua mallra të shumta dhe janë dërguar në terminal doganor. Gjithashtu, ka raste që kamionët paguajnë taksën, dhe hyjnë sipas procedurave ligjore. Statistikat e kontrabandës tregojnë se numri i tyre është në rritje dhe këtë fakt e cilësojmë si rezultat pozitiv.

Albert Kinolli, sipas tij, Policinë e Kosovës e konsideron si institucionin më të besueshëm në vend. Shprehet se ka konsideratë për pjesëtarët e saj, sidomos në suazat e rrezikshmërisë së tyre gjatë punës në terren. Theksoi, në listën e konkursit të fundit të shpallur nga Policia e Kosovës, nuk ka pasur asnjë të dyshuar nga rrada e komunitetit rom, për veprë penale.

Megjithatë, shprehu shqetësimin e tij, se nga 34 aplikues, asnjë pjesëtar i komunitetit rom nuk është pranuar, në këtë afat. Konstatoi se është në rritje numri i të arsimuarve të komunitetit rom, edhe për kundër faktit se ata nuk shkollohen në gjuhën e tyre amtare. Si kërkesë e tij ishte, që kjo ministri të punojë më shumë në këtë drejtim, me mundësi të përfshihen në numër të barabartë edhe komuniteti rom, në këtë institucion.

Drejtori z. Qalaj, duke iu referuar shqetësimit të z. Kinolli, theksoi se konkursi i Policisë së Kosovës ka qenë i paanshëm dhe standardet kanë qenë të njëjta për të gjitha komunitetet. Në kuadër të përfshirjes në numër më të madhe të komuniteteve, ai propozoi që të hartohet një plan i veprimit në mes të Policisë së Kosovës dhe komunitetit rom, në suaza të organizimit të seminareve e kampanjave të ndryshme.

Ndërsa sa i përket rastit të përmendura nga **z. Ademi**, ai, potencoi se gjykatat dhe Shërbimi Korrektues, janë ato të cilat përcaktojnë nivelin e dënimeve për veprat penale.

Slobodan Petroviq, përmendi rastet e kërcënimeve që po i bëhen nga personat e institucioneve publike, për të cilët ka edhe emra konkretë. Sipas mendimit të tij, kur kryerësit e veprave penale janë të njohur, ka hapësirë për vepra tjera, të njëjta. Lidhur me këtë çështje, ka probleme jo vetëm Policia por edhe prokuroria dhe gjykatat. Për rastet të cilat ai pretendon se nuk ka marrë përgjigje, jo vetëm në këtë mbledhje, por ka rastet të zbulimit të kryerësve të veprave penale dhe vrasjet politike, duke iu referuar edhe vrasjeve në veri gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2014, dhe vrasjes së Oliver Ivanović. Edhe njëherë shprehu nevojën, se duhet të punohet më shumë në gjetjen e kryerësve të këtyre veprave penale. Në fund, falënderoi Policinë e Kosovës, për punën e bërë, deri më tani.

Drejtori, z. Qalaj, duke u solidarizuar me shqetësimin e tij, bën ftesë publike, që paraprakisht të lajmërohen të gjitha rastet, jo vetëm në stacionet policore lokale por edhe ato rajonale. Për rastin e vrasjes së të ndjerit z. Oliver Ivanoviq, tha se ka një progres në procesin e hetimit, nga se rasti është duke u trajtuar nga Prokuroria Speciale.

Në fund tha se nuk mund të japë informata më të detajuara për shkak të ndjeshmërisë së rastit, por siguroi z. Petroviq, se do të dërgojë raportin me shkrim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

*Përgatitur nga
Njësia mbështetëse e komisionit*

Zëvendëskryetar i komisionit,

Xhelal Sveçla